

XHAHIL BILBILI



MAŠKA  
dhe  
FYTYRA

XHAHIL BILBILI

~~20128~~

BIBLIOTEKA E SHETETIT  
GJIROKASTËR

20128

M A S K A

E

F Y T Y R A


N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1960

Redaktor: S. Caci  
Ilustrimet: B. Fico

Tirazhi: 1000      format 70 X 100 1/32      Stash. 2204-55

---

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë



## KOZMOS 1959\*

Alarm në qiell një mëngjes, sivjet ...  
 Ç'qenë Shejtanë, Ëngjëj e Shënjtore,  
 panë në Kozmos edhe një planet  
 — ndër aq e aq planetë madhështorë —  
 të vogël, piciruk, që fluturonte  
 rreth Diellit. «Kush vallë po kuxonte  
 të prishë armoninë e Gjithësisë  
 q'e ka krijuar dor' e Perëndisë?»

U provokua mbledhje menjëherë  
— ku s'merrnin pjesë, natyrisht, Shejtanë —  
dhe raportoi Shën Pjetri: — N'atë sferë  
po shoh... ca drapërinj e ca çekanë!  
Pra, gjersa erdhën dhe tek Zoti drejt,  
Bota përposh do jetë skuqur krejt!...


---

\*) Në Janar 1950 shkencë Sovjetike lëshoi satelitin e  
parë artificial të Diellit.

## A F R I K A U Z G J U A !


Afrika u zgjua! Pyje shekullore  
dhe shkretëtira rëre të pa-anë  
buçasin nga kushtrime madhështore  
zezakësh: «Rrokni armët, afrikanë!»  
Alarme lakuriqësh me tam-tamë  
tmerojnë çdolloj bish' e egërsirë  
— hiena, tigër, ujq, ipopotamë —  
të ardhur nga Evropa mysafirë...

Zotrinj fisnikë, që s'kanë djersitur  
përveç se nëpër salla vallëzimi  
dhe çdo pallat të tyre e kanë ngritur  
mbi shekuj skllavërie e mjerimi,  
futën në portofol ndjenjat fetare  
dhe në valixhe mjaft qytetërim,  
u veshën me qëllime humanitare  
dhe shkuan në Afrikë me shërbim...



Të Kapitalit ishin misionarë...  
Me shtatën e me kryqin pararojë,  
marshuan nëpër pyje duke qarë  
— si krokodili kur s'ka gjë në gojë —  
«për fatin e zezakëve të mjerë»  
edhe u falën njerësve të lirë  
diçka që s'kishin mbatur asnjëherë  
si byzylyk: **ZINXHIRE!**

**Imperialistë! Po buçet tufani!**  
**Djelli tropik ju përvëloi! Qani!**




### MËSHIRË DEMOKRISTIANE

- Një i papunë, i cili pat trokitur  
n'uzina e fabrika pa sukses,  
kur pa se do të vdiste duke pritur  
i shkoi mësëfundi një mëngjes,  
pasi mbaroi mesha, famulltarit:
- Jam me një tufë kalamaj, uratë...
  - Ju njiheni me shumë industrialë...
  - Për fat të keq, unë njoh vetëm gratë  
që vijnë e më rrëfehen, more djalë...

— Të vdes, ahere? — Jo, të rrosh me shpresë!  
Zoti s'mbron veç të varfër e të gjorë...  
Eni pra çdo të dielë në meshë  
t'ju jap nga pak... naforë!







## RACIZËM

- Si quhesh? - Xhon Uilliams - Vjeç? -- Tridhjetë.
- Rraca? - Zezak - Martuar? - Jo, beqar.
- Të puthi ajo, apo e puthe vetë?
- Më puthi ajo... - S'e ditke, mor zuzar, se është faj të puthet një i zi me një të bardhë? - Po, këtë e di.
- Ahere, kur t'u qas, pse nuk e çporre?
- Që ta nderoj si racë superore...

## HUMANIZËM KAPITALIST

### I

Dhe vdekja Misis Perkins e rrëmbeu  
— pa mbushur mirë tetëdhjetë vjet —  
një mbrëmje dimërore shënëdreu  
tek rrinte shtrirë tërë salltanet  
në kanapën e saj, duke shtrënguar  
një Buletin të Bursës nëpër duar.

### II

E fyshkur zhabë mu si fik i thatë,  
me nja tre dhëmb'e gjysëm të gërryer,  
nuk i shijoi goja dot kungatë  
as pati mundësi për të rrëfyer  
të mirat që pat bërë ajo — sa herë! —  
si milionere dhe si e krishterë...  
Se që kur vdiq i shoqi — pastë ndjesë! —  
dhimbja e saj e madhe u shërua  
vetëm me një besim të madh ndaj Fesë,  
se cilës Misis Perkins iu kushtua  
me vepra mirësie të çdo fare  
për qëniet fatkeqe e nevojtare.

### III

Po mbasi mirësit 'harrohen lehtë  
— si ka provuar shumë herë jeta —  
dhe do lëndohej fort vejush'e shkretë,  
i ra ndërmënd të blejë dy gazeta;  
do flisnin, në «rubrikën shoqërore»,  
për veprat e «kristianes shëmbëllore»,  
po pa përmëndur kurrë hollësira,  
sepse e dhathta s'bën t'ja marrë vesh  
së mëngjërës veprat e saj të mira:  
dollarët që shpërndante ajo me thes  
për bukë, për veshmbathje, për studime,  
për paja nusërie dhe mjekime...


### IV


Pra, Misis Perkins vdiq si e krishterë...  
Një pikëllim i math nxiu qytetin,  
porse një lajm e zbardhi menjëherë  
që thoshte se «ajo fitoi Xhenetin,  
sepse e la të gjithë pasurinë  
me shkrim, në testament, për varfërinë...

### V

Dhe ja, noteri nisi të lexojë.  
Njerëzit, rretherrrotull, s'marrin frymë...  
«Xhekut një milion, të më kujtojë.  
Dy milion për Merin, si viktimë,  
se ngeli për qef tim e pamartuar.  
Tre miliona Billit, që më ruante  
çdo natë në shtëpin'e vetëmuar.  
Dhe pesë Tonit tim, i cili vuante  
kur e shikonte varur burrin tim  
në mur karshi krevatit plot trishtim...»

Njerëzit po shikohen të habitur...  
 Kush jan'ata q'u bënë milionerë?  
 Asnjë s'bën gëk... Kur ja, shumë tronditur,  
 po i sqaron noteri ata të mjerë  
 me buzën që i dridhet si për vaj:  
 «Këta të katër janë qent e saj...»





### NË NJË APARTAMENT

- Mor ç'bën kështu?! Paskë çkalluar fare?  
— E ç'bëj-a! Sharroj derën, a i vvarë,  
që të këcejnë këto djall manare  
përposh, nëpër qilarë!
- Ç'përposh, mor, më llafose! Nuk e di  
se kjo shtëpi ku rri është mall Shteti?  
— E, a derë-zi,  
se s'bënetë qameti!...

## THËNGJILLI I MBULUAR

Eprori im, atje ku punoj unë,  
besa të merr më qafë si njeri:  
atë s'e ke veçse për zyr'e punë;  
ay kërkon, pa fjalë, llogari;  
ay nuk e bën veten kurrë lojë  
t'asaj që quhet familjaritet,  
po dhe kur do diçka ta imponojë,  
ka takt, ndiell respekt. Dhe kjo të vret!

«S'ka nerva» thonë ca. Është e vërtetë.  
«Është gjakftohtë» thonë ca të tjerë.  
Kushdo q'është nevrik dhe e di vetë  
ç'pasoja ka të ndizesh menjëherë  
si kashta, e çmon fort gjakftohtësinë  
që mban ay me dinjitet dhe art,  
e sidomos kur ndodh, me dishiplinë,  
ta kritikojë kush nga poshtë lart.


Nuk e prish gjakun hiç, po mban mëri.  
Veshët i hap, po gojën gëk, e qep.  
Edhe kështu nuk e pikas njeri  
se çdo kritikë ay e fut në xhep  
dhe pret që, kur ta sjellë rasti mbarë,  
t'hakmerret ndaj atij që pat kuxuar  
të prekë pakëz hirin, ku s'kish parë  
thëngjillin e mbuluar...

Të transferon, dhe vete me pak shpresë  
mos — ishalla! — s'pranon... Po refuzove,  
ahere rri e të qëndis një shkresë  
e cila të njofton se «U pushove,

mbasi ke dezertuar nga detyra,  
duke i sjellë dëm planit të Shtetit  
me sjellje dhe mënyra  
të huaja për njerzit e pushtetit «

\*\*\*

Eprori im, atje ku punoj unë,  
«për hir të punës...» po të le pa punë !



## AUTORITETI

Paradhënie merr Filani  
gjithënjë kur ka nevojë  
që të shkojë në pjetore  
më të ngrysur e t'ja shtrojë;  
që t'i bëjë një dhuratë  
nonjë vajze, me... kamatë;  
që ta tundë disa net,  
për martes'o për synet;  
me pak fjalë — kurdoherë  
që një shef i llogarisë,  
sapo nis të qajë foshnja,  
e afron e i jep sisë...

— Do të mbyllim tremujorin...  
Ato lekët, shok drejtor...  
— Vallahi... — Po un'i shkreti?  
— S'kam, ç'të bëj, të bje theror?  
— Nejtë... — Gjeju nonjë vrimë...  
— Janë shumë, mor aman!  
— E vërtit ti, s'ta kam frikën;  
do t'ja gjesh nonjë derman...

Dhe kjo lidhje materiale,  
dalngadale... dalngadale,  
huamarrësin e gjorë  
— nga një dash q'ish me këmborë —  
po e bën sheleg të butë  
dhe i vesh fustan e futë.  
— Ay folka për kursime  
edhe pro ligjëshmërisë,




q'është futur gjer në grykë  
borxhëlli i Llogarisë?

— Pse e zgjat? Këtu tek ne  
nuk ka tresh e bilmeme!

Ta do qefi, s'ta do qefi,  
do të bësh si thotë shefi ...

\* \* \*

«Autoritet i nënës,  
ç'të të qaj më parë?  
Nderin e kam nip,  
Lekun e kam djalë!»





## PARAZITËT

Të gjith'e dimë  
se disa bimë  
gjejnë një pemë për qelepirë;  
mbijn'aty pranë  
dhe rrin'a hanë  
nga buk'e botës si s'ka më mirë...

20128  
BIBLIOTEKA E SHTETIT  
GJIRONKASTËR 17

Kështu, përditë  
ca parazitë  
gjat gjith'orarit vijnë vërdallë.  
Le që s'punojnë,  
po ngatërrojnë;  
dhe kur vjen puna, ngrihen me pallë  
të kritikojnë,  
të demaskojnë  
për çdo mungesë shokët e tjerë,  
për të mbuluar  
me këmb'e duar  
q'ata s'prodhojnë veçse poterë!

Po ndërsa ndodhen  
këta që s'lodhen  
veç për të folur me zhurmë shumë,  
ca parazitë  
rrinë të mpitë,  
s'flasin, jetojnë si nëpër gjumë.  
Kokulur, t'heshitur,  
rrinë parreshtur  
plot tetë orë në një tryezë.  
Sikur mendojnë...  
Sikur krijojnë...  
Po s'jan'as kllçka, të ngrohën vezë...

## JUSTIFIKIMI

Ndërsa një dhi që kish uri,  
si pa të keq, një ditë vjeshte,  
na ishte shtruar bukuri  
dhe hante gjethet e një vreshte,  
iu kthye vreshta e i tha:  
— Ç'të bënë gjethet që m'i ha?  
Gjer sot të bëra nonjë faj?  
— Deri sot, jo, po paskëtaj,  
ia priti dhia menjëherë.  
Sikur bariu të më therë,  
ti që kërkon tani mëshirë,  
do t'i japsh verë që t'i tretë  
thelat e mia ca më mirë... —  
Dhe s'i la vreshtës as një fletë!




## KUJTIME...

A të kujtohet, Enrieta?  
Shkuan q'ahere kaqë vjet...  
Oh! Sa e ëmbël duket jeta  
kur çdo kujtim për ty më flet!

Më treten syt'e dëshëruar  
lark, shumë lark, si n'ëndërrime,  
edhe një çast të paharruar  
më ngjall çdo rrahj'e zëmrës sime...

Na ftoi, të heshtur, një mëngjes,  
provimi i fundit në maturë.  
Dhe ne u ulëm, me kujdes,  
si s'do të uleshim më kurrë...



Prej asaj banke ku qëndronje  
më ngulnje syt'e mallëngjyer,  
sikur kërkonje t'i ndalonje  
çastet që iknin të pakthyer...

Dhe un'i shihnja syt'e shkruar  
që diç kërkonin të më thonë  
me një vështrim të përmalluar  
q'e kam përpara gjithëmonë,


po nuk kuptonja Enrietë,  
se ti s'kërkonje syrin tim,  
veç pakëz ndihmë, një biletë,  
se ishe tapë në provim...

#### M E T A N I R A T

Tregojnë se një dallëndyshe  
që e nderonte shumë Fenë  
shkoi në murin e një kishe  
edhe atje ndërtoi folenë.

Po kur një dit' ajo kish shkuar  
të mbledh' ushqim për çilimitë,  
rrëshqet një gjarpër i mallkuar  
dhe ja ha zogjtë një nga një...

Sapo u kthye nën' e mjerë  
dhe mori vesh se ç'i kish ngjarë,  
thirri, me shpirtin helm e vrer:  
«Kjo pik'e zezë s'është parë!  
Si?! Jetëshkurtër zogjt e mi  
te kjo shtëpi, ku un' e shkreta  
kam bërë kaqë metani  
tu zgjatet jeta?»



## MËNDJEMADHËSIA

Një grumbull mizash fluturonin  
mbi një kusi që s'kish kapak,  
i vinin rrotull, po s'kuxonin  
t'i qasen pranë. Kur pas pak,  
njëra prej tyre u afrua,  
u ngroh një çikë, u turbullua  
dhe ra në lëngun e kuisë...  
Në kulmin e fatkeqësisë,  
nuk u përkul as kësaj here;  
se, kur po mbytej në tenxhere,  
u tha të tjerave: «Pushoni!  
E kë përcillni duke qarë?  
Mua, që vdes — si po shikoni —  
e ngrënë, e pirë dhe e larë?»

## BUKUROSHI

- Mbaroi djali i Qazos për doktor...
- Vërtet?! Pse mos mbarojë, e ka për sojë...
- E kur na vjen? - Paşnesër, me vapor...
- Hanë, moj, dhe në dasmë, të të rrojë! -  
Dhe Nefua jep e merr me ato glikò  
e Qazua mbush gotat e rakisë,  
dhe bota ha e pi e komento  
me të kaluar prakun e shtëpisë:
- U hapi derën pleqëve të shkretë!
- Si lum ata me mjekun në shtëpi!
- Tani të zestë pleq do shohin jetë!
- Le mos e nga! Kësmet në pleqëri! -

Mballomaxhi pat qënë Qazo ziu,  
me jetën gjithëmonë të arnuar  
dhe Nefon shërbëtore nëpër dyer  
esnafësh e bejlerësh të nderuar.  
Po kohërat ndryshuan dhe për ta,  
si për të gjitha dyertë jetime,  
dhe Bukuroshin një mëngjes e nisën  
me bursë jashtë shtetit për studime.

E nisën, po s'i thanë: Merr diplomën...  
Fryju si gjel me stetoskop në veshë...  
Mos dil kurrë me prindërit shetitje  
se bën vaki dikush të të përqeshë...  
Mos fto në shtëpi kurrë shokë e miq,  
se plaka jote s'di si të qerasë,  
se plaku yt po bje erë lëkurë  
dhe do të bëhesh gazi i dynjasë...  
Pastaj merr nonjë grua pispiluce  
që do independencë familjare,  
braktisi pleqtë, merr shtëpi më vete  
dhe rro i lirë fare...»





Sa ëndërra të bukura të prindërve  
i bëri djali i vetëm cop' e thrime!  
Sa këngë e nina-nana të dikurshme  
u kthyen në vajtime!

— Po prapë, o xha Qazo, nuk ju lë  
pa gjë ky djali juaj, xhevahiri:  
po pate nonjë vrimë në këpucë,  
arroje me... diplomën e tët biri!

## KUJT T'JA MOLLOIS?

Pesë vjet me grua,  
ç'më ka gjetur mua;  
kujt t'ja mollois?  
U ndava nga halli,  
sot e për së gjalli,  
nga miq e nga fis!


Ku është dëgjuar  
burri i martuar  
të mos mund të presë  
mysafirë: tanë,  
tëmën e vëllanë,  
një nip e një mbesë?

Kur vijnë të mitë,  
naaa...i var turitë,  
sikur do t'i hajë!  
Po të shohsh ç'nderime  
— në shtëpinë time —  
njerësve të sajë!

Ajo mblidh e sill,  
unë prit-përcill  
fisin me nderime;  
ky ishte kësmeti:  
shtëpi e tim eti  
han i gruas sime!

— Mblidhja, mor — më thonë —  
mos rri sus gjithmonë!  
Ndero dhe të tutël!  
Qënke bërë grua,  
o lum' e përrua,  
me fustan e futël!





## KRITIKËVE

Lulishtja jonë kulturele  
ka dhe ca lule, rrall e tek,  
që janë shumë «artistike»  
dhe e kanë emrin «mos më prek».


Mbyllin petalet menjëherë  
sikur tu qasësh pakëz dorën,  
se kanë hall se mos nonjeri,  
përmbi çdo gjë, u prek... kurorën.

Edhe në çast, si për protestë  
ndaj më të vogëlit cënim,  
marrin vendim të pezullojnë  
çdo kundërmim...

Lulishtja jonë kulture  
ka dhe ca lule, tek e tek,  
që janë tepër delikate  
ndaj çdo kritike që i prek...

\* \* \*

«Kujdes e takt, se është frikë  
mos fyshken lulet, o Kritikë!»



## NË SHKOLLËN E NATËS

Në shkollën e natës, i dashur lexuës,  
ku shkoj edhe unë si shkon edhe ti,  
në njerën nga lëndët ne kemi mësuës  
një burrë zotni!


Nonjë nxënës nate — n'daç burr'i martuar  
që hedh nonjë gotë dhe nis të dalldiset,  
n'daç djalë beqar tërë zjarr në krahuar  
që pret sa të ngriset —

shpesh her' është krunde kur kemi Fizikë  
po prapë se prapë ay nuk ka frikë.

Sepse ay «nxënës» e ka mjaft të qartë  
që nota e Fizikës nuk është e vështirë,  
se zoti mësues ka zëmër të artë  
dhe dorë të lirë...

Po si mund ta prishë, për hir të një treshi,  
me nxënës që tapë i vijnë përditë,  
kur disa prej tyre, me sa i zu veshi,  
na paskan pozitë?

Pas Ligjit Fizik, nuk mund të besohet  
se nota humbet e s'lë gjurma pas saj,  
sepse edhe kjo, si «çdo gjë transformohet»  
në... mik më pastaj!



Në shkollën, e natës, i dashur lexuës,  
ku shkoj edhe unë si shkon edhe ti,  
në njerën nga lëndët ne kemi mësues  
një burrë... ZOTNI!


## STOQE

Kur themi stoqe, niset mëndja jonë  
dhe shkon në akësh depo t'errësuar  
ku fle Kualiteti përgjithmonë  
gjumin e amëshuar.

Ja veshmbathje, ja reçeje,  
ja mobilje e turshira,  
ja dhe pije e karamele  
e të tjera mrekullira.

Po ka dhe disa depo posht'e lart  
ku stoqet s'janë mallra tregëtare,  
po të konfeksionuara me «art»  
dhe quhen zyrtarisht «stoqe letrare».

Ja tregime t'afirmuar  
me ca dhjetra personazhe,  
q' autori i ka dënuar  
të jetojnë n'ambalazhe;





ja poema tërë ujë,  
mu si lum' që rjedh me bujë,  
dhe mbi nonjë varg letrar  
autori lundërtar  
që përpiket fort i gjori  
mos e merr lumi q'ë mori:  
ja dhe vjersha prozaike  
— prej talentesh të kalitur —  
me përmbajtje... metalike,  
për fëmijë e për të rritur...

### RUAJE ZOT !

Këtu, në portofolin tim,  
kam një fotografi të shtrënjtë,  
atë e ruaj për kujtim  
si gjënë time më të shënjtë.  
Nuk është e nënës, e vëllajt,  
e foshnjës, gruas, o babajt,  
e nonjë mbese o kushëriri,  
po e një miku-xhevahiri!

E cilën t'i harroj më parë  
nga mirësitë që kam parë?  
Ay, në kohën q'u martova,  
foli me njerin në strehim  
edhe kështu u sistemova  
vetëm me një telefonim...  
Dhe përsëri ky mik me kokë  
— që i peshon fjala me okë —  
kur trëmbesha mos ngel në klasë  
edhe i thashë që t'i flasë  
një pedagogu n'Institut,  
shkoi, me takt, edhe iu lut.  
S'kalonja dot si nxënës nate  
pa gjetur disa monopate...



**Ky mik, q'e kam për çdo nevojë,  
i lutem Zotit të më rrojë  
dhe bëj duara të qëndrojë  
n'atë pozitë që ka sot...  
Ruaje, Zot!**

PASHË...

Pashë njëditzaj një varrim  
dhe priftin në veturë,  
po fort të pikëlluar...  
Dhe rri duke menduar:  
«Pse vall' e ka këtë merak?  
Pr' atë që s'kthehet kurrë,  
apo sepse... i dhanë pak?

## TUFA E VJERSHAVE

|                             | Faqe |
|-----------------------------|------|
| Kozmos 1958 .....           | 3    |
| Afrika u zgjua! .....       | 4    |
| Mëshirë Demokristiane ..... | 6    |
| Racizëm .....               | 8    |
| Humanizëm kapitalist .....  | 9    |
| Metanirat .....             | 11   |
| Në një apartament .....     | 12   |
| Thëngjilli i mbuluar .....  | 13   |
| Autoriteti .....            | 15   |
| Parazitët .....             | 17   |
| Justifikimi .....           | 19   |
| Kujtime .....               | 20   |
| Mëndjemadhësia .....        | 22   |
| Bukuroshi .....             | 23   |
| Kujt t'ja mollois? .....    | 25   |
| Kritikëve .....             | 27   |
| Në shkollën e natës.....    | 29   |
| Stoqe .....                 | 31   |
| Rueje Zot! .....            | 32   |
| Pashë .....                 | 34   |